



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 231/5 prot.

Datë 28.02.2023

V E N D I M
Nr. 156/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.02.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: “Anullimi i procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18- 2023 me objekt: Loti 5 “Blerje bojë, materiale, etj ”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane.*

Ankimues: Operatori ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK
Adresa: Rruga e Kavajës, Kompleksi Delijorgji, Përballë Rogat Security, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë
Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë KPP dhe autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.01.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me REF-56255-01-18- 2023 me objekt: Loti 5 “*Blerje bojë, materiale, etj*”, me fond limit *1.405.666,25 lekë pa TVSH*, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, *Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane*.

II.2. Në datën 02.02.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. “FREDI ELECTRONICS” SHPK | 22.340 lekë, kualifikuar |
| 2. “GENERAL PLUS” SHPK | 33.710 lekë, kualifikuar |

II.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 09.02.2023 ka publikuar Njoftimin e Fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.4. Në datën 06.02.2023 operatori ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 231/2 prot., datë 07.02.2023 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “GENERAL PLUS” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 180/56 prot., datë 10.02.2023, protokolluar me tonën me nr. 231/3 prot., datë 15.02.2023 me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacionin e procedurës së prokurimit si dhe vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.7. Me shkresën datë 28.002.2023, protokolluar me tonën me nr. 231/4 prot., datë 28.02.2023 me objekt “Kërkesë për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria “General Plus” shpk.” është depozituar nga operataori ekonomik ankimues “GENERAL PLUS” SHPK në Komisionin e Prokurimit Publik kërkesa si më poshtë vijon:

“Në datën 07/02/2023 shoqëria “General Plus” shpk ka paraqitur ankesë në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: Loti 5: Blerje boje, materiale, etj”, me fond limit 1,405,666.25 (një milionë e katërqind e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë presje njëzetë e pesë) lekë pa tvsh, nga Autoriteti kontraktor “Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë”.

Kjo ankesë është paraqitur përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit nga ana e Autoritetit Kontraktor, por ne kërkojmë shqyrtimin në themel të saj. Ankesa e paraqitur nga ana jonë nuk ka të bëjë me arsye skualifikimi të ndonjë prej operatorëve dhe nuk çenohet nga publikimi i njoftimit të fituesit që është publikuar pas datës së depozitimit të ankesës.

E gjejmë të nevojshme të bëjmë këtë kërkesë për të konfirmuar se edhe pas publikimit të njoftimit të fituesit vullneti jonë për të kërkuar shqyrtimin e ankesës mbetet i njëjtë.

Referuar ligjit nr. 44/2015 “KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” nuk ka asnjë parashikim për rastin e fillimit të një procedure administrative mbi bazën e një ankese të paraqitur përpara afatit. Në këtë rast mbetet në diskrecionin e organit administrativ t’ja kthejë menjëherë kërkuarit ankesën duke e njoftuar për paraqitjen e saj përpara afatit dhe duke i dhënë udhëzimet përkatëse ose t’a mbajë pezull deri në krijimin e kushteve procedurale për trajtimin e saj.”

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton

III.1. Në datën 19.01.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18- 2023 me objekt: Loti 5 “Blerje bojë, materiale, etj ”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane.

III.2. Në datën 02.02.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “FREDI ELECTRONICS” SHPK 22.340 lekë, kualifikuar
2. “GENERAL PLUS” SHPK 33.710 lekë, kualifikuar

III.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 09.02.2023 ka publikuar Njoftimin e Fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.4. Në datën 06.02.2023 operatori ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 231/2 prot., datë 07.02.2023 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “GENERAL PLUS” SHPK.

III.6. Me shkresën nr. 180/56 prot., datë 10.02.2023, protokolluar me tonën me nr. 231/3 prot., datë 15.02.2023 me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacionin e procedurës së prokurimit si dhe vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë.

III.7. Me shkresën datë 28.002.2023, protokolluar me tonën me nr. 231/4 prot., datë 28.02.2023 me objekt “Kërkesë për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria “General

Plus” shpk.” është depozituar nga operataori ekonomik ankimues “GENERAL PLUS” SHPK në Komisionin e Prokurimit Publik kërkesa si më poshtë vijon:

“Në datën 07/02/2023 shoqëria “General Plus” shpk ka paraqitur ankesë në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: Loti 5: Blerje boje, materiale, etj”, me fond limit 1,405,666.25 (një milionë e katërqind e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë presje njëzetë e pesë) lekë pa tvsh, nga Autoriteti kontraktor “Spitali Universitar Shefqet Ndroqi Tiranë”.

Kjo ankesë është paraqitur përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit nga ana e Autoritetit Kontraktor, por ne kërkojmë shqyrtimin në themel të saj. Ankesa e paraqitur nga ana jonë nuk ka të bëjë me arsye skualifikimi të ndonjë prej operatorëve dhe nuk çenohet nga publikimi i njoftimit të fituesit që është publikuar pas datës së depozitimit të ankesës.

E gjejmë të nevojshme të bëjmë këtë kërkesë për të konfirmuar se edhe pas publikimit të njoftimit të fituesit vullneti jonë për të kërkuar shqyrtimin e ankesës mbetet i njëjtë.

Referuar ligjit nr. 44/2015 “KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” nuk ka asnjë parashikim për rastin e fillimit të një procedure administrative mbi bazën e një ankesë të paraqitur përpara afatit. Në këtë rast mbetet në diskrecionin e organit administrativ t’ja kthejë menjëherë kërkuarit ankesën duke e njoftuar për paraqitjen e saj përpara afatit dhe duke i dhënë udhëzimet përkatëse ose t’a mbajë pezull deri në krijimin e kushteve proceduriale për trajtimin e saj.”

III.8. Në nenin 97, pika 1 “Njoftimi i Fituesit” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”.*

III.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimit” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në*

autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.11. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.12. . Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vlerësimit/klasifikimit për vete ose të tjerë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në *Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE)*, u konstatua, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit në datën 09.02.2023, ndërkohë që për këtë procedurë prokurimi, operatori ekonomik ankimues “GENERAL PLUS” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 06.02.2023, si dhe pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vlerësimit/klasifikimit për vete ose të tjerë të procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis në datën 09.02.2023.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në KPP dhe në autoritetin kontraktor në datë 06.02.2023, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj

III.13. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit

Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “GENERAL PLUS” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me REF-56255-01-18-2023 me objekt: Loti 5 “Blerje bojë, materiale, etj”, me fond limit 1.405.666,25 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tirane.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “GENERAL PLUS” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri